

## SHPËTIM ELEZI

### VEÇORI GRAMATIKORE TË MBIEMRIT NË ÇETËN<sup>1</sup> E BOGDANIT

#### 1. Hyrje

Mbiemri në aspektin strukturor dhe kuptimor është përbërës fakultativ i *sintagmës emërore*, të cilën e plotëson kuptimisht duke shprehur një veçori a cilësi të saj dhe në aspektin funksional është përcaktor i saj, ose është në funksion kallëzuesori. Si element përcaktues i emrit bërthamë të sintagmës emërore, mbiemri varet nga emri, por edhe mund të hiqet pa ndryshuar funksionin e sintagmës emërore. Kur themi i varur nga emri, kemi parasysh faktin që në gjuhën shqipe, sipas pikëpamjes së Lyons-it (2001: 301), eptimi mbiemëror (gjinia, numri dhe rasa), si një dukuri e qartë e strukturës sipërfaqësore, varet nga rregullat transformativë të përshtatjes së tij me emrin. Së këndejmi, edhe Gramatika e shqipes e përkufizon mbiemrin “si pjesë e ligjëratës që emërton një tipar (cilësi, veti, marrëdhënie) të sendit dhe përshtatet në gjini, në numër e, për një pjesë, edhe në rasë me emrin e këtij sendi.”<sup>2</sup>

Sa i përket veprës *Çeta e profetëve* të Bogdanit, mbiemri përdoret mjaft dendur, prandaj dhe ofron mundësi të mira studimi të strukturës dhe të veçorive të tij morfologjike, si numrin, gjininë, rasën dhe shkallën. Tri veçoritë e para (gjinia, numri, rasa) janë vështruar në lidhshmëri me ato të emrit, nga kategoritë e të cilit varen. Por, sa i përket përshtatjes së mbiemrit me emrin në numër, në gjini e në rasë, do thënë se kjo vlen vetëm për të nyjshmit, të cilët këtë dukuri e realizojnë kryesisht nëpërmjet trajtave rasore të nyjës së përparme e, më rrallë, edhe përmes mbaresave dhe alternimeve morfofonologjike, sepse, nga ana tjetër, të panyjshmit përshtaten me emrin vetëm në gjini e në numër me anë të formanteve mbaresores, por jo edhe në rasë, pasi ata e kanë humbur kategorinë e rasës.<sup>3</sup>

Në këtë punim, gjithashtu, janë përshkruar edhe veçoritë e mbiemrave të nyjshëm dhe të panyjshëm, klasifikim ky i bërë sipas rrafshit formal morfologjik në Gramatikën e shqipes.<sup>4</sup> Por, me këtë rast, nuk janë vështruar veçoritë e mbiemrave të klasifikuar nga Gramatika e shqipes<sup>5</sup> sipas rrafshit kuptimor-funksional: cilësorë dhe marrëdhëniorë, sipas taksonomisë semantike, si dhe as

---

<sup>1</sup> Për këtë punim si korpus hulumtimi na ka shërbyer botimi i përgatitur nga studiuesja Anila Omari, *Pjetër Bogdani, Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve)*, Botim kritik, Tiranë, 2005.

<sup>2</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe I*, AShSh, IGjL, Tiranë, 2002, f. 153.

<sup>3</sup> Shih më hollësisht për këtë Sh. Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1988, f. 417-438.

<sup>4</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe I*, AShSh, IGjL, Tiranë, 2002, f. 158-160.

<sup>5</sup> *Gramatika e gjuhës shqipe I*, AShSh, IGjL, Tiranë, 2002, f. 155-157.

sipas këndvështrimit të tekstit: mbiemra që shprehin qëndrim dhe mbiemra që nuk shprehin qëndrim.<sup>6</sup>

Për sa i takon përshtatjes së mbiemrit të nyjshëm me emrin për nga kategoria gramatikore e rasës, po mjaftohemi këtu të japim disa veçori të kësaj kategorie të *Çeta*, në të cilën ka shembuj që dëshmojnë se kjo shprehet jo vetëm përmes formave rasore të nyjës së mbiemrit, sikundër ndodh ekskluzivisht në shqipen e sotme, por, në numrin shumë, edhe në saje të mbaresave të njëjta rasore: bjeshkëshit *së naltash* (I, 5), *vepëravet [të]<sup>7</sup> mirave* (Të primitë XIV), bishash *së egrash* (II, 130), të dëshirëvet *[të]këqiave* (I, 87), viseshit *së njomash* (I, 37), të gjithë kafshëvet *[të]gjällavet* (I, 51), të dëshirëvet *[të] këqiave t'pëmbrendshimevet* (I, 87) etj. Por, në ndonjë rast, edhe të panyjshmit në numrin shumë lakohen bashkë me emrin, si: të vashëzavet *lodërtareve* (I, 157) etj.

Po kështu do thënë se, për dallim nga shqipja e sotme ku kemi njëfarë thjeshtimi të trajtave rasore të nyjës së mbiemrave, te Bogdani (dhe tek autorët e tjerë të vjetër para tij) na del edhe trajta nyjore mbiemërore *së* në rrjedhoren njëjës te mbiemrat e gjinisë mashkullore e asnjënjëse dhe në rrjedhoren shumë te mbiemrat e të tri gjinive. P.sh. ...tue u rrëzuem bjeshkëshit fort *së naltash* (I, 5), fjalësh *së dashunash* (II, 95), bishash *së egrash* (II, 130).

Këtë dukuri të lakimit të emrit bashkë me mbiemrin, qoftë duke marrë mbarësata të njëjta rasore, apo edhe nëpërmjet trajtës nyjore mbiemërore *së* në rasën rrjedhore, Kolë Ashta e sheh të përhapur në mbarë shqipen e moçme, pasi “gjurmët e këtij përdorimi hasen që nga Buzuku e Matrënga e gjer te Bogdani, por edhe pas tij për një farë kohe.”<sup>8</sup>

Megjithëkëtë, format e palakuara të kësaj kategorie leksiko-gramatikore shfaqen më shpesh në tekst, sikur janë po kështu më të shpeshta edhe trajtat rasore me nyjë të thjeshtuar të mbiemrave: *kafshëvet të hyjënueshime* (I, 6), mpkateve *të ndëjyem* (II, 98) e të tjerë shembuj që do të jepen në vazhdim të punimit.

Më tej, interes te Bogdani, sa i përket kësaj kategorie leksiko-gramatikore, paraqesin edhe mjetet e ndryshme trajtë e fjalëformuese, përshtatja në numër e në gjini me pjesët e tjera të ligjëratës, veçmas me emrin, që veç e veç janë vështuar më poshtë.

## 2. Veçori të mbiemrave të nyjshëm dhe të panyjshëm

Veçori karakteristike e mbiemrit është paranyjëzimi, një risi kjo e zhvilluar brendapërbrenda shqipes, e cila ka ndikuar që në këtë gjuhë si në asnjë gjuhë tjetër

<sup>6</sup> Shih për këtë klasifikim B. Rugova – L. Sejdiu-Rugova, *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*, KOHA, Prishtinë, 2015, f. 167-169.

<sup>7</sup> Mbiemrat e nyjshëm, si në këtë rast, por edhe në raste të tjera, te vepra e Bogdanit dalin mjaft shpesh pa nyjë të përparme, me siguri nën ndikimin e gjuhës së folur. Në vijim të punimit, shembujt e këtyre të mbiemrave të nyjshëm të shfaqur pa nyjë në tekstin e Bogdanit do të shënohen me kllapa të mëdha, [i, e, të, së].

<sup>8</sup> K. Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe IV (vepra Cuneus Prophetarum)*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2002, f. 80.

## Veçori gramatikore të mbiemrit në *Çetën* e Bogdanit

IE, madje as në rumanishten<sup>9</sup>, të krijohen dy tipa mbiemrash: të nyjshëm dhe të panyjshëm. Këta dy lloj mbiemrash, që i kundërvihen njëri-tjetrit për nga ndërtimi dhe për nga veçoritë morfosintaksore, hetohen mjaft dendur në tekstin e Bogdanit, si ata të parmë, ashtu edhe jo të parmë. P.sh.:

*të nyjshëm:* vepërat e mira, Hyji [i] naltë, fjalë të gjalla; dyer të huej, të liga tregëti, e madhe dob; lëngime të forta, zot fort i urtë, gramatikë fort të godiçime, kafshë të rë; e hollë, fjalë të harrueme, fort e frujtueshime, fjalë të shkurtëna e jo fort të çtjella, shtylla e njimendë, e pëlqyeshime; vështëri të përzjarshime, zot fort i dashunë (Të primitë XIV, XV, XVI, XVII, XVIII), e papāme, i amëshueshim, i mëshëriershim, i dërejtë, e vogëlë, (I, 1), i amblë, i vetëmë, e rgjanta, i bëgatë, të qelbëta (I, 2) etj.

*të panyjshëm:* giuhësë arbëneshë, giuhëshit konfinjëtare, fjalë plaka, engjëlli shtrazëtār, fësë katolike (Të primitë XV, XVII, XVIII), përpis, ntretës (I, 3), madhështuer (I, 7), krijues (I, 1), letërar (I, 13), vjetsh (I, 94), pajtues (I, 175), italiane (Ligj. IV 179), ata mixorë xhelata (II, 118), mavi (II, 119), shëlbues (I, 11), nye hipostatik (II, 14), rrenëce (I, 166), gjakësuer (II, 110), lëvdues (II, 34), nierë bujar (II, 3), ndër nierëz dvekëtar (I, 162), ndëpër hirtë shëjtënuor (I, 151), fjalë heretike (I, 28), ngushëllues (II, 36), një nierë fort kurvār (I, 28) etj.

Të nyjshmit, siç shihet nga shembujt lart, përshtaten me emrin që përcaktojnë në gjini, në numër dhe në rasë me anë të treguesve të ndryshëm gramatikorë, kryesisht me anë të formave rasore të nyjës së përparme, ndërkaq të panyjshmit përshtaten vetëm në gjini dhe në numër nëpërmjet formanteve mbaresore.

Pjesa më e madhe e mbiemrave shqip në *Çetën* e Bogdanit paraqiten analitikë, që do të thotë se të nyjshmit kanë një denduri përdorimi shumë më të madhe sesa të panyjshmit. Numri i këtyre të fundit shtohet vetëm në saje të krijimit të tyre me konversion nga emrat gjegjës (p.sh. *italian, arbënesh, plak, katolik, krijues* etj.). Sidoqoftë, mjafton që të dy llojet e mbiemrave dallohen dukshëm mes veti në një tekst të shekullit XVII, i së cilës kohë është “Çeta e profetëve”. E një dallim kaq i kristalizuar i tyre në tekstin në fjalë (dhe në tekstet e tjera të vjetra pararendëse), na jep të kuptojmë se ky proces dyzimi i mbiemrave do të ketë ndodhur kohë përpara fazës shkrimore të shqipes<sup>10</sup>.

Disa mbiemra të nyjshëm, Bogdani te *Çeta* e tij i shkruan pa nyjë, si: Hyji *naltë*, vepëravet *mirave* (Të primitë XIV), nierë *armatisunë* (II, 39), shenji *bukurë* (I, 52), kafshëvet *pasosura* (I, 6), zotënisë *randë* (I, 8), Arbënit *poshtërë* (Ligj. VI 181), Krishti *nalcuem* (I, 167), Krisht’ *ambl’* (I, 169), gjytet ndë Aziet *vogëlë*,

<sup>9</sup> Në gjuhën rumune, ndryshe nga shqipja, studiuesit vënë re se i njëjti mbiemër del herë i paranyjëzuar e herë i paparanyjëzuar, varësisht nga rrethanat sintaksore.

<sup>10</sup> Besim Bokshi është i mendimit se ky proces është krijuar në kohën e kontakteve të shqipes me greqishten e latinishten. Shih më hollësisht për këtë B. Bokshi, *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, AShAK, Prishtinë, 2005, f. 447-452.

*mrekulluem* regji (I, 170), *nierëzitetë ndëgueshim* (I, 95), të gjithë kafshëvet *gjalllavet*, i ati Noeut *dërejtë* (I, 51).

### 3. Gjinia

Për sa i përket gjinisë, në tekstin e Bogdanit kjo kategori gramatikore dëshmohet me dy veçori, që lidhen me dy klasat e mbiemrave. E para, mbiemrat e nyjshëm në numrin njëjës, kur përcaktojnë emra asnjans kryesisht prejmbiemërorë e prejppjesorë të paranyjësuar, por edhe emra asnjans të parmë, të Çeta dalin formalisht me kundërvënien tripalëshe: mashkullore, femërore e asnjansë. Siç do të mund të shihet edhe më poshtë, element karakterizues i gjinisë asnjansë të mbiemrave del përgjithësisht nyja e përparme *të*, por edhe nyja *e*, kur mbiemri përcakton emra të shquar në rasën emërore e kallëzore.

*mashkullorë:* libër *i çelë*, krue *i gjallë* (I, 1), djal' *i bukurë* (I, 10), njeri *i përshpirçim* (I, 35), *i madh* gazmend (II, 128), anëmik *i mbëluenë* (II, 99) etj.

*femërorë:* shtasë *e vogëlë* (I, 1), *e amëshueshime* (I, 6), *e patëmirë* (I, 7), madhështi *e paudhë* (I, 8), Virgjëna *e ngushëllueme* (II, 131), *e vërtetë shentën* (II, 97), punë *e vërtetë* (I, 83) etj.

*asnjanës:* kryet ende e kish fort *të lig* (II, 114), të dvekunitë *të mirë* (I, 34), *të amblë* të dashunë (I, 7), *të madh* të dhimptunë (II, 127), *të mirë* të bame (I, 87); t' idhunitë e të dhimptunitë *e fortë* (II, 114), *të mirë* të bām (II, 23) etj.

Por, në numrin njëjës ndeshim edhe shembuj që dëshmojnë se mbiemra asnjans të nyjshëm, edhe kur përcaktojnë emra asnjans, shfaqen me forma të gjinisë mashkullore: e *ma i madh të dashunit* (II, 94), *i madh kje të dhimptunitë* qi pat fort e lumeja Virgjinë (II, 114), Oh sa *i madhtë dhimptunë* kje (II, 123) etj.

Pra, mbiemri në veprën e Bogdanit, varësisht nga gjinia e emrit që përcakton, dëshmohet me forma të ndryshme gjinie, ashtu sikur ndodh edhe në shqipen e sotme. Khs: *m. peshk i madh* (I, 143) – *f.e madhe* dobī (Të primitë XV) – *as.të madh* të dhimptunë (II, 127).

Përgjithësisht, në CP gjejmë mjaft mbiemra të gjinisë asnjansë, të cilët janë dëshmi e mirë se gjer në shek. XVII këta mbiemra janë ruajtur relativisht mirë, edhe pse në numrin shumës gjinitë femërore e asnjansë paraqiten të njësuara, çka parakupton se tanimë mbiemrat dalin dypalësh: mashkullorë e femërorë. P.sh.:

*mashkullorë:* peneza *t'artë* (I, 170), kërthijt *e pagëzue* (I, 34), ujq *të tërbuem* (II, 114), nierëz *t'egrë* (II, 125), *të dashunë* miq (II, 124), gjind kaqa *t'egrë* e *t'armatisunë* (II, 99), konopë *të fortë* (II, 100) etj.

*femërorë:* vepëra *të mira*, fjalë *të gjalla* (Të primitë XIV), dyer *të bukura*, vashëza *të ndershime* e *të mira* (I, 157), kafshë *të nshefun*a (I, 10), përralla *të spifun*a (I, 35), petëka *të përsipërshime* (II, 119), barëna *të paçmue* (II, 127) etj.

Ndërkaq, nga ana tjetër, të panyjshmit, si në njëjës, ashtu dhe në shumës, i ndeshim të përdorur me forma të dallueshme vetëm për gjinitë mashkullore e femërore, pa pasur forma të posaçme për gjininë asnjansë. P.sh.:

## Veçori gramatikore të mbiemrit në Çetën e Bogdanit

- mashkullorë:* ky *tradhëtuer* Juda (II, 99), engjëlli *shtrazëtār* (Të primitë XVIII), *përpis*, *ntretës* (I, 3), *madhështuer* (I, 7), *krijues* (I, 1), *letërar* (I, 13), *pajtuës* (I, 175), *mixorë* xhelata (II, 118), *mavi* (II, 119), *originall* (I, 33), korp *mistik*, Testament *Plak* (I, 83), *nji nierī gjyturim e paralitik* (II, 55) etj.
- femërorë:* e *giuhësë arbëneshë*<sup>11</sup>, *giuhëshit konfinjëtare*, fjalë *plaka*, *fësë katolike* (Të primitë), *italiane* (Ligj. IV 179), faje *venialle*, pendesa të mpkatevet *mortare* (I, 34), ndë S. Kishë aqa *luftëtare* sa *ngushëllore* (II, 74), nd atë kishë *landëtare* (II, 17), profetesë *rrenëce* (I, 166), *heretike* (I, 28), ma e vogla *shërbëtore* (II, 12), fara e keqe e *kopile* (I, 61) etj.

Ashtu si në shqipen e sotme, edhe në tekstin e Bogdanit mbiemrat femërorë të nyjshëm formohen nga mbiemrat e gjinisë mashkullore, kryesisht duke ndërruar vetëm nyjën e përparme *i* në *e*: *m. kje Jaku i vogëlë* (II, 100) – *f. nji shtasë e vogëlë* (I, 1), kurse ata që mbarojnë me temë me *-m* e formojnë gjininë femërore duke ndërruar nyjën *i* në *e* dhe duke marrë morfemën femërorizuese *-e*, si: *m. āti i amëshueshim* (I, 152) – *f. dijeja e amëshueshime* (II, I/I 4). Kështu e formojnë gjininë femërore edhe disa mbiemra që mbarojnë me temë me bashkëtingëllore, si: *m. peshk i madh* (I, 143) – *f. e madhe dobī* (Të primitë XV); *m. moti i keq* (I, 143) – *f. e keqe* (I, 43, si edhe *epatëkeqe*), *m. Deti i Kuq* (I, 35) – *f. ranë të kuqe* (I, 35). Kurse një grup i veçantë mbiemrash të nyjshëm të tipit: *i rī* (II, 100), *i zī* (I, 23), *i lig* (I, 50), *i pafund*, *i vobek* (II, 21) e formojnë gjininë femërore kështu: *të rē* (II, 8), e *zeza*, (*krip*)*zez* (II, 7, 158), *e ligë* (I, 26), *e pafundë* (I, 33), *Virgjinë fort së vobekë* (II, 21).

Ndërkaq, sa u takon mbiemrave të panyjshëm, numri më i madh prej tyre e ndërtojnë gjininë femërore duke i shtuar temës së gjinisë mashkullore formantin femërorizues *-e*, ashtu si të nyjshmit: *m. Jozefi landëtār* (II, 36), *kopil* (II, 155), *rrotullar* (II, 58), Tarkuini *madhështuer* (I, 170), – *f. nd atë kishë landëtare* (II, 17), fara e keqe e *kopile* (I, 61), *rrotullare* (II, 47), *madhështore* (II, 107), ndërsa një grup tjetër e formon gjininë femërore pa e ndryshuar formën e gjinisë mashkullore, si: *jetëgiatë* (I, 43), *barkthatë* (II, 13), *Virgjinë kaqë fatamirë* (II, 12) etj. Në këtë mënyrë e formojnë gjininë femërore kryesisht një pjesë e mbiemrave të përbërë, elementi dytë i të cilëve është një mbiemër që edhe jashtë strukturës së kompozitës nuk e ndërron trajtën e tij (khs. *m. i giatë* – *f. e giatë*). Kështu del edhe ndonjë mbiemër i tipit *mavi* (II, 119) etj. Në rastin e mbiemrave të përbërë, trajta e tyre në gjininë femërore del ashtu siç e formon elementi i dytë i mbiemrit të përbërë, që është zakonisht një temë mbiemërore, si: *m. nji nierī fort bamkeq* (II, 110), *nji gjarpënë dijekeq* (I, 47) – *f. ajo gjind cmërkeqe* (II, 107), *kripzī* – *kripzez* (II, 158), *bukë melekuqe* (II, 40), *Mrī hiplota* (II, 12) etj., si dhe një grup tjetër mbiemrash të formuar me konversion prej emrash e ndërtojnë gjininë

<sup>11</sup> Mbiemri *arbënesh* del herë me nyjë e herë pa nyjë: ndë shumë fjalë *t'arbënesh*a (Të primitë XVI), xgedhësi ynë *i arbëneshë* (Të primitë XVIII).

femëroresikurse emrat përkatës. P.sh.: Testament *Plak* (I, 83) – ligja *plakë* (I, 151) etj.

#### 4. Numri

Në vazhdim do të vështrojmë mënyrat e formimit të shumësit të mbiemrave në gjuhën e Pjetër Bogdanit, të cilat janë të ndryshme midis dy gjinive dhe midis dy grupeve të mbiemrave, të nyjshëm e të panyjshëm.

##### 4.1. Formimi i shumësit të mbiemrave mashkullorë

*Të nyjshmit* në veprën e Bogdanit e formojnë shumësin duke e ndërruar nyjën e përparme *i* në *të*. Këtë lloj shumësi e bëjnë si mbiemrat e parmë, ashtu edhe mbiemrat jo të parmë. P.sh.: *i bëgatë* – *të bëgatë* (I, 43), *i amëshueshim* – *të amëshueshim* (I, 1), ky zot fort *i urtë* (Të primitë XVI) – nierëz aqa *t'urtë* (I, 5), *i mirë* (I, 6) – *të mirë* (I, 33), *i dëlirë* (I, 26) – *të dëlirë* (I, 33), *i kulluem* (I, 26) – *të kulluem* (I, 33), *i ftofëtë* (I, 26) – *të ftofëtë* (I, 36), *i hollë* (I, 37) – *të hollë* (I, 36), nierë *[i]armatisunë* (II 39) – nierëz *t'armatisunë* (I, 92), *i dijtëshim* (II, 36) – *të dijtëshim* (II, 27), *i bukurë* (II, 36) – *të bukurë* (I, 86) etj. Mbiemrat *i vobek*, *i madh*, *i vogëlë*, *i keq* bëjnë përjashtim nga ky grup. Mbiemri *i vobek* (sot: *i vobektë*) e ndërton shumësin duke ndërruar nyjën *i* në *të* dhe me palatalizim të bashkëtingëllores fundore *-k* në *-q*, si: *i vobek* – *të vobeq* (I, 43); mbiemri *i madh* e ndërton shumësin pos duke ndërruar nyjën e përparme *i* në *të* edhe duke ndërruar zanoren *-a*-të temës në *-ë*-, si dhe duke marrë mbaresën e shumësit *-ej*: *i madh* (I, 1) – tre qiell *të mëdhej* (I, 22); mbiemri *i vogëlë* (sot: *i vogël*) e ndërton shumësin duke ndërruar nyjën e përparme *i* në *të* dhe vetëm me qiellzorizim të velarit *-g*-në palatalin *-gj*-, pra pa metafonizim të *-o*- në *-e*-, si: *i vogëlë* (I, 1) – krenat' e engjijet ma *t'vogjëlë* (I, 22); mbiemri *i keq* e formon shumësin duke reduktuar zanoren *-e*-të temës në *-ë*- dhe duke marrë njëkohësisht mbaresën e shumësit *-ij*, përveçndërrimit të nyjës së përparme *i* në *të*. P.sh.: nj. E heshtën kur nieri *i keq* mundon ma të mirënë se është vetë? sh. Disa janë aqa *të këqij*, sa nukë mundenë askurraj me u dëlirunë (I, 34).

*Të panyjshmit* në tekstin e Bogdanit e formojnë shumësin varësisht nga mënyra e fjalëformimit të tyre. Të panyjshmit që nuk janë fjalë të përbëra e formojnë shumësin: a) duke marrë mbaresën *-ë*, si: *letërar* (I, 13) – *letërarë* (II, 44), ata *mixorë* xhelata (II, 118), t'ishin kjanë *arapë* (II, 158), *zemërorë* (II, 40), *shërbëtyrë* (II, 42), *gjentilë o paganë* (I, 78) etj., por një shembull shumësi pa *-ë* si ky: ndër nierëz *dvekëtar* (I, 162) dëshmon për jokonsekuencë të shkrimit të tyre; b) duke e ruajtur të pandryshuar trajtën e njëjësit. Në këtë grup hyjnë mbiemra të formuar me prapashtesën *-sh*, si: katërdhjetë *ditsh* (II, 14), 80 *vjetsh* (II, 8) etj. Këtu hyjnë edhe mbiemrat e tipit *përpris*, *ntretës* (I, 3), *krijues* (I, 7), *pajtues* (I, 175), *shëlbues*, *lëvdues* (II, 34), *ngushëllues* (II, 36) etj., të cilët janë të formuar me prapashtesat: *-(ë)s* dhe *-ues*; c) duke marrë mbaresën *-j*, si, p.sh., mbiemri *qefalij* (II, 40) e të tjerë mbiemra si ky që mbarojnë me *-i* fundore të theksuar; ç) ashtu si emrat përkatës, prej të cilëve janë formuar me konversion: nj. *rrenëc* (II, 78) – *rrenëca* (II, 42), nj. kush është *trim* (I, 43) – sh. *trima* (II, 176) etj.

Mbiemrat e përbërë e formojnë shumësin ashtu siç e formon elementi i dytë i tyre, kur përdoret i mëvetësishëm. P.sh.: *jetëgiatë* (I, 44), *barkthatë* (II, 13), një

## Veçori gramatikore të mbiemrit në Çetën e Bogdanit

niert fort *bankeq* ndë burg (II, 110) – kjenë *vepërëkëqī* (II, 78) etj. Këtu hyjnë gjithë mbiemrat e përbërë që kanë si element të dytë një mbiemër ose një emër të gjinisë mashkullore a femërore.

### 4.2. Formimi i shumësit të mbiemrave femërorë

*Të nyjshmit* e gjinisë femërore në veprën e Bogdanit e formojnë shumësin:

a) duke ndryshuar vetëm nyjën e përparme *e* të njëjësit në *të*. Në këtë mënyrë e formojnë shumësin mbiemrat që në njëjës dalin në *-e*. Khs.:

*nyjës*: Virgjëna e *ngushëllueme* (II, 131), atë fjalë të *shemptueme* (I, 33), *e papāme* (I, 1), *e dhunueshime* (I, 9), një fjalë të *vetëme* (II, 99), *vepëra pakëzë e mërziçime* (Të primitë XVII), fort *e frujtueshime*, *e godiçime*, *e pëlqyeshime* (Të primitë XVII), fjala *e amëshueshime* (I, 87), një dhunëti *e përmetueme* (I, 22), *e ujësishime* (I, 25), *e pafuqishime*, *e lëngueshime* (I, 26), *e shemptueshime* (I, 33) etj.

*shumës*: kafshë të *ngushëllueme* (II, 2), të atyne *t'shemptueme* fëtyrave djemënet (I, 33). *vashëza të ndershime* (I, 157), me disa të tjera të *shkrueme* (I, 166), *petëka të përsipërshime* (II, 119), kafshë fort të *anëkueshime* (II, 126), *barëna të paçmueme* (II, 127), fjalë të *harrueme* (Të primitë XVII), *vështëri të përzjarshime* (Të primitë XVIII), *petëka të shëkrueme* (I, 100), fjalë të *nierëzishime* (II, 125), shumë të tjera të *mrekullueshime* (I, 37) etj.

b) duke ndryshuar nyjën e përparme *e* të njëjësit në *të* dhe duke marrë njëherazi mbaresën *-a*. Kështu e ndërtojnë shumësin gjithë mbiemrat që në njëjës nuk mbarojnë me *-e*, si: *e ligë* (I, 26) – *të liga* tregëti (Të primitë XV), *vepëra fort e naltë* (Të primitë XVII) – *çardaqa fort të nalta* (I, 2), *e mirë* (I, 4) – *vërtyte të mira* (II, 4), *zemërën e fortë* (I, 23) – *lëngime të forta* (Të primitë XVI), *kafshë e gjallë* (I, 35) – fjalë të *gjalla* (Të primitë XIV), *e ftofëtë* (I, 25) – *rë të ftofëta* (I, 37), *era e poshtërë* (I, 38) – *shpella të poshtëra* (I, 38) etj.

Te vepra e Bogdanit dëshmojnë edhe mbiemra të gjinisë femërore, si: *e keqe*, *e madhe*, *e rë*, të cilët e ndërtojnë shumësin ndryshe nga mbiemrat e mësipërm. P.sh.: me die të *keqe* (I, 22) – *kafshë fort të këqia* (I, 4); *e madhe* dobī (Të primitë XV) – *djersë të mëdhā* (Të primitë XVII), me këtë fëdigë *kafshë të rë* (Të primitë XVI) – *fëdigë të rea* (I, 88), *kafshë të rea* (I, 23).

Në përgjithësi, vëmë re se në CP janë përdorur më shumë mbiemra të gjinisë femërore sesa mashkullore në numrin shumës. Një gjë të tillë e kushtëzon ambiguiteti i emrit, pasi një tip emrash mashkullorë kur kalojnë në shumës e ndërrojnë edhe gjininë nga mashkullore në femërore, e për rrjedhojë një ndryshim të tillë gjinie e pësojnë edhe përcaktorët e tyre.

*Të panyjshmit* që dalin me fundoren *-e* e ruajnë trajtën e njëjësit. Këtu hyjnë të gjithë mbiemrat që nuk janë të përbërë. Khs.:

*nyjës*: fjalë *heretike* (I, 28), e bija e Atlantit *italiane* (I, 179), e giuhësë *arbëreshe*

(Të primitë XV), giuhëshit *konfinjëtare* (Të primitë XV), *fësë katolike* (Të primitë XVIII), *feja katolike* (I, 7), për profetesë të larme e *rrenëce* (I, 166), *njij zotëneshe* shoqënie (I, 7), *madhështore*, *cmīrore* (II, 107), ma e

vogla *shërbëtore* (II, 12), fara e keqe e *kopile* (I, 61), nd atë kishë *landëtare* (II, 17) etj.

*shumës*: Siblejet *Persike* (I, 165), të katër mëndyrëve *anëmike* (I, 44), me disa faje

*venialle* (I, 34), ndë mjedis të vashëzavet*lodërtare-ve* (I, 157) – [këtu mbiemri i panyjshëm *lodërtare* merr mbaresën rasore *-ve*], pendesa të mpkatevet *mortare* (I, 34), tue kjanë *rrotullare* (I, 33), punëtë *kundërshtare* (II, 17) etj.

Ndërkaq, mbiemri *plakë* e formon shumësin duke marrë mbaresën *-a*: nj. fjala *plakë* (I, 28), shtëpia *plakë*, ligja *plakë* (I, 151) – sh. fjalë *plaka*, mbas disa fjalësh *plaka* (Të primitë XVII), pra, siç shihet, njësoj sikur emri *plakë* – *plaka*, nga vjen me konversion. Në këtë mënyrë e ndërtojnë shumësin edhe këta mbiemra: vashëza *Sibila* (I, 157), vepërat e tñaj të mira, të forta e *mashkulla* (I, 65), ky i fundit me kuptimin burrërore.

Mbiemrat e panyjshëm të gjinisë femërore që janë fjalë të përbëra e formojnë shumësin ashtu siç e formon elementi i dytë i tyre, kur përdoret i mëvetësishëm. Element i dytë i këtyre mbiemrave mund të jetë një mbiemër ose një emër i gjinisë mashkullore a femërore. P.sh.: *melekuqe* (II, 40), nj. të përzanët është *mballëfaqe* – sh. valëvet detit, të pashime e të tmerueshime e *mballëfaqe* (I, 108), *hirplota* (II, 12) etj.

**Shënim 1.** Mbiemrin e panyjshëm *vjeç* te Bogdani e gjejmë të përdorur në 52 raste vetëm me formën *vjetsh*. Me këtë trajtë ky mbiemër përdoret si në rastet kur cilëson një emër të gjinisë mashkullore, ashtu edhe kur cilëson një emër femëror, si në numrin njëjës, ashtu edhe në numrin shumës. P.sh.: Eva fort e *bukurë*, posikur t'ish kjanë 20 *vjetsh* e Adami posi 30 *vjetsh*, e lumeja Virgjinë trë *vjetsh* (I, 6). Ky mbiemër në tekstin e Bogdanit na shfaqet herë i paravendosur e herë i prapavendosur. P.sh.: Ishte Seti 105 *vjetsh*, e leu Enos. Enos *vjetsh* 90 leu Mellallielë.

**Shënim 2.** Mbiemri *i shenjtë* në një tekst fetar si *Çeta* e Bogdanit është përdorur mjaft dendur, por duke u shfaqur pa një të përparme dhe me formën *shêjt*, pra me jonizim të *nj-së* në *j*. Në tekst e gjejmë të shkruar me tri trajta: *shêjt*, me *-e-* nazale, *shent*, me *-e-* gojore, si p.sh.: të Shkruemit *Shent* (I, 12) dhe me trajtën *shint*, si: të Shkruemit *Shint* (II, 157) etj., por me një përdorim dukshëm më të madh të trajtës së parë.

Kur përcakton një emër të gjinisë mashkullore, në pozicion para ose pas tij, ky mbiemër përdoret rregullisht me trajtën *shêjt*, pa ndonjë tregues gjinie, respektivisht pa *-ë* fundore, si: Ungjilli *shêjt* (I, 73), të shpirtit *Shêjt*, së Shpirtit *Shêjt*, (I, 6), Shpirti *Shêjt*, për Shpirtinë *Shêjt* (I, 7, 10), nd atë vend *shêjt* (I, 6), *shêjt* korp të Shëlbuesit, korpne *shêjt*, Plaku *shêjt* (II, 125), arka e Shpirtit *Shêjt* (II, 2) etj.

Me këtë trajtë ky mbiemër përdoret kur cilëson edhe një emër asnjanes, si: t'Shkruemit *Shêjt*, ndë të Shkruemit *Shêjt*, (I, 6) etj.

Ndërkaq, kur cilëson një emër të gjinisë femërore, përdoret me treguesin *-e*, qoftë në pozicion para emrit apo pas tij, qoftë kur përdoret në numrin njëjës apo në numrin shumës, si: Virgjina *Shêjte* (I, 105), Virgjëneja fort *Shêjte* (I, 2), bukurin' e Virgjënësë *Shêjte* (I, 4); këjo *shêjte* Virgjinë (II, 2), *shêjte* fë (I, 7), pr atë *shêjte* kishë, *shêjte* rangë, ajo *Shêjte* Virgjinë; ato *shêjte* vashëza, ato *shêjte* mjeshtëri, *shêjte* virgjinatë, ato *shêjte* virgjina (II, 6, 7, 8).

## Veçori gramatikore të mbiemrit në Çetën e Bogdanit

Këtë mbiemër e gjejmë edhe të emëruar, madje në tërë paradigmen e tij, si: *shêjteja* fë (Të primitë XIV), *Shêjti* Prof. Gjob, ndënë pushtë të shêjtit atit Papë (II, 5), kafshët e shêjtësë fë (I, 23), *shêjtesë* fë (I, 6), *shêjtenë* fë (Të primitë XVIII) etj.

Krahas mbiemrit të parmë *shêjti*, në tekst dëshmohen edhe mbiemrat jo të parmë, të formuar mbi bazën e temës fjalëformuese *shêjt*: *i shêjtënueshim*, *i shêjtënuem* dhe *shêjtënuor*. P.sh.: Virgjina e *shêjtënueshime* (II, 2), ujëna të *shêjtënueme* (I, 61), ndëpër hirtë *shêjtënuor* (I, 151).

### 5. Përfundime

Mbiemri në veprën *Çeta e profetëve* të Bogdanit përdoret mjaft dendur dhe dëshmohet me veçori të ndryshme morfologjike në kategori si: numri, gjinia dhe rasi. Këto tri kategori të mbiemrit, të vështruara në lidhshmëri me ato të emrit, dëshmohen me veçori që karakterizojnë gjuhën e Bogdanit dhe shqipen e shekullit XVII.

Për sa i takon përshtatjes së mbiemrit të nyjshëm me emrin për nga kategoria gramatikore e rasës, u pa që kjo shprehet jo vetëm përmes formave rasore të nyjës së mbiemrit, sikundër ndodh ekskluzivisht në shqipen e sotme, por, në numrin shumë, edhe në saje të mbaresave të njëjta rasore në grupin e mbiemrave të nyjshëm: bjeshkëshit *së naltash* (I, 5), por në ndonjë rast kjo veçori dëshmohej edhe në klasën e mbiemrave të panyjshëm: të vashëzavet *lodërtareve* (I, 157). Po kështu u pa se, ndryshe nga shqipja e sotme, te Bogdani (dhe tek autorët e tjerë të vjetër) del edhe trajta nyjore mbiemërore *së* në rrjedhoren njëjës të mbiemrat e gjinisë mashkullore e asnjënjëse dhe në rrjedhoren shumë të mbiemrat e të tri gjinive: fjalësh *së dashunash* (II, 95). Pra, lakimi i emrit bashkë me mbiemrin, qoftë duke marrë mbaresat të njëjta rasore, apo edhe nëpërmjet trajtës nyjore mbiemërore *së* në rasën rrjedhore, duhet të ketë qenë dukuri e mbarë shqipes së kohës, pasi kjo haset edhe tek autorët e tjerë të vjetër pararendës e pasues.

Sa i përket llojeve të mbiemrave sipas rrafshit formal, u pa që te ky autor mbiemrat më shumë janë të tipit strukturor analitik, pra, të nyjshëm, të cilët dukshëm dalin më dendur se të panyjshmit. Ky dallim kaq i kristalizuar i tyre në tekstin në fjalë (dhe në tekstet e tjera të vjetra pararendëse), na jep të kuptojmë se ky proces dyzimi i mbiemrave do të ketë ndodhur kohë përpara fazës shkrimore të shqipes dhe në këtë fazë tashmë dalin mirë të konsoliduar, ndonëse Bogdani, i ndikuar nga gjuha e gjallë, jo pak herë të nyjshmit i shkruan fare pa nyjë: *niër armatisunë* (II, 39).

Kurse gjinia e mbiemrave të nyjshëm te Bogdani në numrin njëjës u pa se dëshmohej formalisht me kundërvënien tripalëshe: mashkullore, femërore, asnjënjëse, duke u përshtatur kështu me emrat përkatës të cilët i përcaktojnë: *m. krue i gjallë* (I, 1) – *f. shtësë e vogëlë* (I, 1) – *as. të dvekunitë të mirë* (I, 34). Në këtë shembullin e fundit shihet se element karakterizues i gjinisë asnjënjëse është nyja e përparme *të*, por, siç është parë më lart, në raste të tjera edhe nyja *e*, kur mbiemri përcakton emra të shquar në rasën emërore e kallëzore. Përgjithësisht, në CP dalin mjaft mbiemra të gjinisë asnjënjëse, gjë që dëshmon se gjer në shek. XVII këta mbiemra janë ruajtur relativisht mirë në paradigmen e numrit njëjës,

por jo edhe në paradigmen e numrit shumës, e cila del e dyzuar: mashkullore – femërore, siç ngjet edhe me të panyjshmit në njëjës e në shumës.

Ashtu si në shqipen e sotme, edhe në tekstin e Bogdanit mbiemrat femërorë të nyjshëm u pa se formohen nga mbiemrat e gjinisë mashkullore, kryesisht duke ndërruar vetëm nyjën e përparme *i* në *e*: *m. kje Jaku i vogëlë* (II, 100) – *f. një shtâsë e vogëlë* (I, 1), kurse ata që mbarojnë në temë me *-m* duke ndërruar nyjën *i* në *e* dhe duke marrë morfemën femërorizuese *-e*: *m. âti i amëshueshim* (I, 152) – *f. dijeja e amëshueshime* (II, I/1 4). Kështu, e formojnë gjininë femërore edhe numri më i madh i mbiemrave të panyjshëm: *m. Jozefi landëtâr* (II, 36) – *f. nd atë kishë landëtare* (II, 17). Mbiemra të tjerë dëshmohen me mënyra të ndryshme formimi të gjinisë femërore.

Kurse, sa i përket numrit, u pa se mënyrat e formimit të shumësit të mbiemrave në gjuhën e Pjetër Bogdanit janë të ndryshme midis dy gjinive dhe midis dy grupeve të mbiemrave, të nyjshëm e të panyjshëm, pasi kjo kushtëzohet edhe nga struktura e tyre e ndryshme. Por numri më i madh i mbiemrave të nyjshëm të gjinisë mashkullore e femërore e formojnë shumësin duke e ndërruar nyjën e përparme *i* në *të*. Khs.: *m. / nj. i bëgatë – sh. të bëgatë* (I, 43); *f. / nj. Virgjëna e ngushëllueme* (II, 131) *sh. kafshë të ngushëllueme* (II, 2). Kurse të panyjshmit e parmë mashkullore e formojnë shumësin me formantin *-ë*, si: *nj. letërar* (I, 13) – *letërarë* (II, 44) karshi femërorë të tillë që e formojnë me formantin *-a*: *era e poshtërë* (I, 38) – *shpella të poshtëra* (I, 38), i cili në pak raste formon edhe shumësa të mbiemrave mashkullore. Disa të tjerë, mashkullore dhe sidomos femërorë të panyjshëm, e ruajnë të pandryshuar trajtën e njëjësit. Krahas këtyre, u pa se te ky autor dëshmohen edhe mënyra të tjera shumësi të mbiemrave mashkullore e femërorë, disa prej të cilave karakterizohen edhe me ndërrime morfologjike dhe me forma aberrante.

#### BIBLIOGRAFI

- A. Omari (2005). *Pjetër Bogdani, Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve)*. Botim kritik. Tiranë: ASHSh, IGjL.
- ASHSh (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë: ASHSh, IGjL.
- B. Rugova –L. Sejdiu-Rugova (2015). *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Prishtinë: KOHA.
- B. Bokshi (2005). *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*. Prishtinë: ASHAK.
- J. Lyons (2001). *Hyrje në gjuhësinë teorike*. [përkth. Ethem Likaj]. Tiranë: Dituria.
- K. Ashta (2002). *Leksiku historik i gjuhës shqipe IV (vepra Cuneus Prophetarum)*. Shkodër: Camaj-Pipa.
- Sh. Demiraj (1988). *Gramatika historike e gjuhës shqipe*. Prishtinë: Rilindja.
- Korpusi:**
- P. Bogdani, *Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve)*. [Botim kritik i përgatitur nga Anila Omari], ASHSh, IGjL, Tiranë, 2005.